

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-26-1345-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Eculizumab, bari orfan per sëmundje të rralla sipas LE**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Medical Group SH.P.K.
NUI	810495722
Adresa	Fehmi Agani 69 /B 10
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	-
Numri Telefonit	038713333
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Mrika Nrecaj
Adresa elektronike	info@medicalgroup-ks.com
Data e parashtrimit të ankesës	06.05.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me Eculizumab, bari orfan per sëmundje të rralla sipas LE

Me 18.03.2026 është përgatitur Dosja e Tenderit për aktivitetin tenderues Furnizim me Eculizumab, bari orfan per sëmundje të rralla sipas LE, identifikuar me numër të prokurimit: 206-26-1345-1-1-1

Me date 23.03.2026 OE Medical Group ka derguar kerkesen per sqarim te dosjes se tenderit ne lidhje me statusin Orfan te produktit dhe kerkesat teknike.

Me date 26.03.2026 AK ka kthyer pergjigje ne kerkesen e OE Medical Group ku ka konstatuar se produkti ka statusin Orfan te percaktuar nga EMA dhe kerkohet CoA qe deshmon te dhenat e produktit.

Me date 15.04.2026 AK ka shpallur vendimin per dhenie te kontrates, ku OE Medical Group shpallet i pasuksesshem dhe AK shperblen me kontrate OE Nini Pharm i cili ka ofertuar me produkte Biosimilare, pa status Orfan si kerkohet ne vet dosjen e tenderit. Produkti i Nini Pharma gjithashtu nuk ka Autorizim Marketingu valid per Kosove.

Më datë 16.04.2026 OE Medical Group Sh.P.K. paraqet këtë Kërkesë për Rishqyrtim.

Me datë 28.04.2026 Autoriteti Kontraktues dërgon Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim. Arsyetimi i refuzimit është i bazuar vetëm në analizën e njëanshme dhe jo të saktë të operatorit të rekomanduar për Kontratë Nini Pharm ShPK. Në anën tjetër, Autoriteti Kontraktues nuk përgjigjet fare në analizat e tij.

06 Maj 2026 – Paraqitet kjo Ankesë në OSHP.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja eshte bere permes platformes e-prokurimi , dhe gjithcka ka qene ne rregull.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Më datë 16.04.2026 OE Medical Group Sh.P.K. paraqet këtë Kërkesë për Rishqyrtim.

Me datë 28.04.2026 Autoriteti Kontraktues dërgon Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim. Arsyetimi i refuzimit është i bazuar vetëm në analizën e njëanshme dhe jo të saktë të operatorit të rekomanduar për Kontratë Nini Pharm ShPK. Në anën tjetër, Autoriteti Kontraktues nuk përgjigjet fare në analizat e tij.

05 Maj 2026 – Paraqitet kjo Ankesë në OSHP.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (“LPP”)

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve – përkundër faktit se vetë Autoriteti Kontraktues në mënyrë të qartë e pranon se oferta e rekomanduar për Kontratë nuk i plotëson kërkesat e Dojës së Tenderit, pikës 9.1 dhe 9.2., kjo pasi nuk klasifikohet si produkt medicinal orfan, të njejtën e rekomandon për Kontratë duke përdorur dokumentacion të produkteve tërësisht tjetër.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. *Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ju lutem referojuni deklaratës së bashkangjitur mbi faktet dhe argumentet.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik Medical Group Sh.P.K. është i detyruar të mbrojë interesat e tij ekonomike dhe ligjore. Rrjedhimisht, në rast të vazhimit të veprimeve kundërligjore, OE në fjalë është i detyruar të veprojë me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, përfshirë kërkesat për kompensim të dëmeve eventuale të cilat kanë ndodhur dhe do të shkaktohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*